



KOMPANISË SË SIGURIMEVE "ELSIG" SH.A.

Bazuar në nenin 57 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1. dhe paragrafin 8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-092, lidhur me nenin 29.8 paragrafin 1 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi I rrugës në Fshatin Radashevc - Lot 5" me nr. të prokurimit 616-22-1552-5-1-1, autoriteti kontraktues-Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit parashtron:

KËRKESË

Për Konfiskimin e sigurimit të tenderit bazuar në të dhënat si në vijim:

Siguruesi, adresa:	K.S. "ELSIG" sh.a., 10000, Prishtinë
Data e sigurimit të tenderit:	14.07.2022
Nr. i polices së sigurimit:	104491
Shuma:	33,070.30 Euro
I siguruari, adresa:	NB COMPANY shpk, Llazarevë - Obiliq
Nr. unik identifikues:	810727563
Emri i përfituesit, adresa:	Komuna e Prishtinës, Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë
Emri i bankës së përfituesit, adresa:	Banka Qendrore e Kosovës, Rr. "Garibaldi" Nr. 33, Prishtinë
IBAN dhe SWIFT CODE të përfituesit:	IBAN: XK05 1000 6502 3000 0067 SWIFT: CBRKXKPRXXX


Arsyetim

Operatori ekonomik: NB COMPANY shpk, Llazarevë - Obiliq, nuk ka zbatuar kontratën dhe kushtet e saj sipas specifikimit teknik. Komisioni për Menaxhim të Kontratës ka konstatuar që me konstatim për ndërprerje të kontratës me nr. 616-22-1552-5-1-1/C839, të datës: 02.05.2023, i cili nuk e ka realizuar kontratën sipas specifikacionit teknik.

Përmes nenit 29.8 paragrafit 1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcaktohet se "AK do të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në situatat e mëposhtme:

a. Në rast të shkeljes së kontratës së nënshkruar, e cila shkakton dëme materiale për AK dhe/ose kërkon që AK të shkaktoj shpenzime të konsiderueshme në përfundimin e kontratës së tillë".

Nga sa u tha më sipër kërkojmë nga autoriteti juaj që të ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për konfiskimin e menjëhershëm të sigurisë së tenderit sipas të dhënave më sipër në këtë kërkesë.




Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Bashkangjitur:

- Sigurimi i ekzekutimit të tenderit (SIGKOS);
- Konstatimin nga Komisioni për Menaxhim të Kontratës;
- Kontrata e nënshkruar me nr. 616-22-1552-5-1-1/C839, të datës: 14.07.2022.

Prishtinë, 13.09.2023

1353 *Flamuri*



Datë/a:	11.09.2023
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Zyrtarin Kryesor Administrativ - z. Përparim Rama
CC:	Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave
Përmes/Preko/Through:	Departamentit për Prokurim
Nga/ Od/ From:	U.D. i Departamentit për Prokurim - z. Visar Shehu
Tema/ Subjekat/Subject:	Akt Përcjellës - Vendim për Ndërprerje të Kontratës



Me anë të këtij akti ju përcjellim Vendimin për Ndërprerje të Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

“Ndërtimi I rrugës në Fshatin Radashevc - Lot 5” ME NR. TË PROKURIMIT: 616 22 10448 521

Adresa:Rr. UÇK-2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon:+381(0)38/230-900
<http://ëëë.prishtina-komuna.org>



Në bazë të nenint 81 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-42, në bazë të nenint 61 par.26, 27, 28 dhe 29 i Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe në bazë të kontratës së lidhur me datë 13.01.2019 ndërmjet Operatorit Ekonomik: " NB COMPANY " SH.P.K., LLAZAREVË, -15000, Obiliq, Kosovë, me numër të biznesit: 810727563, me pronar: Xhevat Binaku dhe Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.09.2023, palët arritën këtë:

VENDIM PËR NDËRPRERJEN E KONTRATËS ME TITULL

"Ndërtimi I rrugës në Fshatin Radashevc - Lot 5"

ME NR. TË PROKURIMIT: 616 22 10448 521

Autoriteti Kontraktues dhe Operatori Ekonomik me datë 14.07.2022, kanë lidhur kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit:

"Ndërtimi I rrugës në Fshatin Radashevc - Lot 5"

ME NR. TË PROKURIMIT: 616 22 10448 521

Me ç'rast pas konstatimit nga Menaxheri i Kontratës z. Qazim Bajrami, Mbikëqyrësi i menaxhimit të Kontratës znj. Amire Krasniqi dhe anëtarët e organit mbikëqyrës z. Hazir Krasniqi dhe z. Jeton Zherka se Operatorëve Ekonomik nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara nga komuna qysh nga fillimi dhe gjithashtu nuk i ka respektuar rekomandimet e Komisionit për menaxhim të kontratës sipas kushteve të kontratës dhe përsëkrimit të çmimit.

Kompania ka qene neglizhuese ne vazhdimësi dhe shume e papërgjegjshme pasi qysh nga fillimi ka pasur pretendime që të distancohet nga përmbushja e kontratës.

Provë: Konstatimi i Komisionit për Menaxhim të Kontratës të datës: 02.05.2023, të dërguar me email zyrtar me datë: 11.09.2023

Poashtu Departamenti i Prokurimit do të filloj procedurën për inicimin e konfiskimit të sigurimit të ekzekutimit sipas kushteve të kontratës.

Kjo marrëveshje ndërmjet palëve është arritur në mënyrë të njëanshme nga Autoriteti Kontraktues në bazë të kushteve të veçanta të kontratës.

Të iu dërgohet:


Operator Ekonomik: " NB COMPANY " SH.P.K

Komisionit për Menaxhim të Kontratës

Departamentit të Prokurimit

Aprovuar nga: Departamenti i Prokurimit

Visar Shehu (Ushtrues Detyre i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit)



Aprovuar nga: Kryetari i Kryeqytetit - Komuna e Prishtinës

Përparim Rama (Zyrtar Kryesor Administrativ)



Prishtinë

11.09.2023.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Datë/a:	02/05/2023
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Departamentin e prokurimit
CC:	DIKMK Qendrës për Komunikim me qytetarë
Përmes/Preko /Through:	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave
Nga/ Od/ From:	Qazim Bajrami menaxher i kontratës
Tema/ Subjekt/Subject:	Propozim për ndërprerjen e kontratës

Kontrata me titull "Ndërtimi i rrugës në fshatin Radashevc –Lot 5" me nr.616-22-1552-5-1-1 dhe nr.të mbrendshëm : 616 22 009 511 ,me OE NB COMPANY SH.P.K. LLAZAREVË.Vlera e kontratës :330,703.00€

Propozoj që të inicohet procedura për ndërprerjen e kontratës për këto arsye:

-punimet kanë filluar me dt.09/08/2022 dhe deri me dt.02/12/2022 duke mos i llogaritur ditët me shi dhe festat kanë kaluar 76 ditë pune,mbrenda këtij afati nuk iu kanë përmbajtur planit dinamik që vet e kanë dorëzuar.Kanë mbetur edhe 44 ditë pune deri në përfundimine kontratës kurse është realizuar vetëm 25% e vlerës së kontratës.

-Me krijimin e kushteve atmosferike i është bërë kërkesë kompanisë që punimet ti fillojnë me dt 01/03/2023.Për arsye të terrenit kodrinoro-malor nuk ka pasur mundësi që të fillojnë punimet.

Në takimin e mbajtur me dt.28/03/2023 në drejtorinë e Investimeve kapitale ku prezent ka qenë përfaqësuesi i OE ,drejtori i drejtorisë dhe menaxheri i kontratës jemi dakorduar që definitivisht punimet të fillojnë me dt.10/04/2023.Me dt.11/04/2023 OE ka kthyer një përgjigje përmes e-mailit se gjoja nuk ka kushte për fillimin e punimeve.

Kushte ka pasur dhe ka pasur mundësi që të fillohet me mure mbrojtëse e shumë pozicione të tjera por nuk i kanë filluar.

Kështu që nga dt. e planifikuar për fillimin e punimeve 10/04/2023 dhe deri me dt.29/04/2023 kanë kaluar më shumë se 15 ditë dhe janë krijuar kushtet për ndërprerjen e kontratës sipas nenit 37 pika a.